



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNI



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/83;
Datë: 30.03.2016 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 21 paragrafi 21.1 pika k) të Statutit të Komunës së Junikut; dhe nenit 16 paragrafi 3. të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 30.03.2016, nxjerrë:

V E N D I M

për fillimin e hartimit të

(projekt) **Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale**

I. Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) **Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale** /në tekstin e mëtejme (projekt) Rregullorja/.

II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) Rregulloreje, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

III. Bartëse e hartimit të (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi është Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

IV. Bartësja e hartimit të (projekt) Rregullores është e obliguar që (projekt) Rregulloren ta hartojë në afat prej 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

V. Autorizohet kryetari i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të emëroj Grupin e punës për hartimin e (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi.

VI. (Projekt) Rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e (projekt) Rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.

VII. Pas hartimit, (projekt) Rregullorja i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

VIII. Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.

IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://rks-gov.net/junik>

X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik Tofaj _____
kryesues